



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
MINISTRI

Nr. 35771, prot

Dh, 28.05.2024

UDHËZIM

Nr. 2, datë 28.5.2024

**“MBI KRITERET DHE AFATET NË LIDHJE ME KËRKESËPROPOZIMET PËR  
MBËSHTETJEN FINANCIARE TË PROJEKTEVE NË FUSHËN E TURIZMIT”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 31/1 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar:

**UDHËZOJ:**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përcaktimin e kritereve dhe afateve në lidhje me kërkësë propozimet për të përfituar mbështetje financiare për projekte dhe veprimtari në fushën e turizmit, sipas parashikimeve të shkronjës “a” dhe “c” të pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar.

2. Për të përfituar mbështetje financiare, kërkësë propozimet në fushën e turizmit duhet që:

- të jenë në përputhje me parimet e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në vend dhe politikat e ministrisë për zhvillimin e industrisë së turizmit;
- të promovojnë industrinë e turizmit për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës;
- të promovojnë produktet dhe destinacionet turistike, vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të vendit në përputhje me kalendarin turistik të aktivitetave zbavitëse;
- të nxisin edukimin profesional të burimeve njerëzore të subjekteve që zhvillojnë veprimtari në fushën e turizmit, në funksion të rritjes së cilësisë dhe përmirësimin e shërbimit;
- të ndikojnë në digjitalizimin e industrisë së turizmit për të rritur efikasitetin e përpjekjeve për zhvillim të produkteve dhe shërbimeve inovative;
- të përmirësojnë kornizën e studimeve apo të modeleve të produkteve turistike;

  
MINISTRIA E TURIZMIT  
PROSESI PËR KREDITET FINANCIARE

II. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI QË PLOTËSOJNË PERSONAT FIZIKË DHE JURIDIKË PËR TË PËRFITUAR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTE NË FUSHËN E TURIZMIT

1. Kriteret që duhet të plotësojë personi fizik, juridik, vendas ose i huaj, (këtu e në vijim "subjekti") për të përfituar mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit, janë si më poshtë:
  - a) të jetë i regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - b) të ketë eksperiencia të ngashme në fushën e kulturës, turizmit, argëtimit, promovimit;
  - c) të mos ketë detyrime përbëimore;
  - d) Të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë;
  - dh) Të ketë përbushur detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
  - e) Të ketë përbushur detyrimet për pagimin e kontributeve shoqërore në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.
2. Dokumentacioni që depozitohet nga subjekti për të përfituar mbështetje financiare është si më poshtë:
  - 2.1 Për projekte dhe veprimtari të ideuara dhe të propozuara nga vetë Ministria përgjegjëse për turizmin/Agjencja Kombëtare e Turizmit, subjekti depoziton:
    - a. Kërkesën që përmban shprehjen e interesit për marrjen pjesë në procedurë;
    - b. Portofolin e veprimtarive dhe aktiviteteve të realizuara ndër vite;
    - c. Certifikatën e regjistrimit, regjistruar në organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi;
    - d. Ekstraktin e regjistrat tregtar, në rast se subjekti është person fizik apo juridik, ose vërtetimin e regjistrimit si Organizatë Jo fitimprurëse;
    - e. Vërtetimin se nuk ka detyrime përbëimore;
    - f. Vërtetim se nuk është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë;
    - g. Vërtetim se ka përbushur detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
    - h. Vërtetim se ka përbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.
  - 2.2 Për projekte të paraqitura nga persona fizikë, juridikë, vendas ose të huaj, subjekti përveç dokumentacionit të parashikuar në shkronjat "b" deri në "h" të pikës 2.1 të këtij udhëzimi, depoziton edhe:
    - a) Formularin e aplikimit, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
    - b) Tabelën e kostove financiare, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Formulari i aplikimit dhe tabela e kostove financiare, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, plotësohet në mënyrë të detajuar dhe që përmban të dhëna të plota për subjektin/ përfaqësuesin ligjor/ përshkrimin e projektit dhe aktiviteteve përbërëse, datave dhe vendeve ku ato zhvillohen, si dhe të kenë të pasqyruara kosto reale të tregut.

### III. AFATET PËR PARAQITJEN E KËRKESË PROPOZIMEVE PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE NË FUSHËN E TURIZMIT

1. Kërkësë propozimet për projektet në fushën e turizmit sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 31, të ligjit 93/2015 i ndryshuar, paraqiten në çdo kohë përgjatë vitit buxhetor:

a. për projektet e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 31, Ministria/ Agjencia Kombëtare e Turizmit bën publike në faqen zyrtare të institucionit propozues dhe/ose në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, thirrjen për aplikim duke specifikuar tematikën ku fokusohet thirrja, kriteret dhe afatet që duhet të plotësojnë subjektet për të përfituar mbështetjen financiare.

b. për projektet e parashikuara në shkronjën “c” të pikës 1, të nenit 31, Ministria/ Agjencia Kombëtare e Turizmit, kërkon bashkëpunimin e subjekteve të specializuara mbi analizën e tregut për veprimtari/ shërbime/ produkte të ngjashme me zërat buxhetore të projektit të ideuar/ propozuar.

2. Rregullat që ndiqen në zbatim të pikës 1, të këtij Kreu, janë si më poshtë:

a. Struktura përgjegjëse për zhvillimin e projekteve dhe veprimitarive në fushën e turizmit në Ministrinë përgjegjëse për turizmin/ Agjencia Kombëtare e Turizmit, harton një memo informuese respektivisht mbi iniciativën konkrete, me një parashikim të përafërt financiar, drejtuar Ministrit përgjegjës për turizmin/ titullarit të institucionit. Struktura përgjegjëse, në varësi të rastit apo kompleksitetit të projektit, merr mendimet paraprake të drejtorive të tjera që lidhen direkt ose indirekt me iniciativën.

b. Ministri përgjegjës për turizmin/ titullari i institucionit, në rast se është dakord me iniciativën, udhëzon ngritjen e kolegjiumit, sipas pikës 1, të nenit 31/1 dhe pikës 2, të nenit 31/3, të Ligjit 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar. Mënyra e funksionimit të kolegjiumit përcaktohet në rregulloren e miratuar nga Ministri përgjegjës për turizmin/ titullari të institucionit, sipas pikës 2, të nenit 31/2 dhe pikës 3, të nenit 31/3, ligjet nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar.

c. Subjekti plotëson kriteret sipas pikës 1, të kreut II dhe depoziton dokumentacionin e parashikuar në pikën 2, të kreut II, të këtij udhëzimi. Në varësi të natyrës së projektit dhe veprimitarisë, me propozim të Kolegjiumit, mund t'i kërkohet subjektit të paraqesë dokumentacion shtesë për të provuar ekspertizën dhe kapacitetin profesional, ekonomik dhe teknik në përbushjen e shërbimit që ofrohet.

3. Ministri përgjegjës për turizmin/ titullari i institucionit, me propozimin e kolegjiumit, miraton projektet dhe veprimtaritë në fushën e turizmit që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit.
4. Lista e projekteve fituese, sipas shkronjës a, të pikës I, të Kreut III, publikohet në faqet zyrtare të Ministrisë përgjegjëse për turizmin/ Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe vijohet me nënshkrimin e kontratave me subjektet fituese.
5. Monitorimi i zbatimit të kontratave dhe realizimit të aktiviteteve kryhet nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit/ Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe/ apo Drejtoritë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Në përfundim të aktivitetit/ projektit, përgatitet relaciioni i monitorimit nga grapi i monitorimit. Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit caktohen me Urdhër Ministri, ndërsa përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe/ apo Drejtoritë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, caktohen rast pas rasti nga titullari i institucionit përkatës.
6. Pagesat e përfituar nga fondi buxhetor do të kryhen 60% e vlerës, të paktën 5 ditë përpara fillimit të projektit dhe 40% e vlerës në përfundim të projektit, kundrejt dokumenteve që vërtetojnë zhvillimin dhe shpenzimet e kryera në shërbim të projektit.
7. Përfitimi finansiar realizohet pasi të depozitohet shkresa drejtuar Drejtorisë së Financës, me të gjitha materialet financiare dhe promovuese të aktivitetit.

#### IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet struktura përgjegjëse për zhvillimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit në Ministrinë përgjegjëse për turizmin/ Agjencinë Kombëtare të Turizmit dhe kolegjiumet përkatëse për zbatimin e këtij udhëzimi.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
ANEKSI 1

FORMULARI I APLIKIMIT

PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET NË  
FUSHËN E TURIZMIT

PJESA I: INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

<b>Titulli i projektit</b>	
<b>Emri i Aplikantit</b>	
<b>Statusi ligjor</b> (së bashku me ndryshimet që kanë pësuar aktet themelore të organizatës, duke bashkëngjitur vendimet përkatëse të gjykatës, Nr.)	<i>Numri i Vendimit dhe Data e regjistrimit në Gjykatë;</i> <i>NIPT-i</i>
	<i>Emri i Bankës</i> <i>Numri IBAN</i> <i>Nr. i Llogarisë Bankare (në lekë)</i>
Adresa:	
E-mail:	
Ëbsite:	
Nr. Tel:	
Kohëzgjatja e projektit	< datë/muaj nga / deri>
Vendi/-et ku zbatohet projekti	
Personi i kontaktit	
Funksioni:	
Buxheti total:	
Fondet e kërkura nga MTM:	
Informacion për bashkëfinancim	
Partnerët e projektit:	

## PJESA II - PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

### Titulli i projektit:

**Qëllimi i projektit:** Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekt u përgjigjet nevojave të identikuara (*maksimumi 10 rreshta*).

[Shpjegoni...]

### Objektivat e projektit (*maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv*):

- [Shpjegoni...]
- [Shpjegoni...]
- [Shpjegoni...]

Etj.

**Aktivitetet kryesore të projektit** (*maksimumi 5 rreshta përshkrim për secilin aktivitet, të planifikuar në çdo fushë*)

- [Shpjegoni...]
- [Shpjegoni...]
- [Shpjegoni...]

Etj.

**A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura?** (*Maksimumi 5 rreshta*):

[Shpjegoni...]

**A është projekti/produkti objektivisht i verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve** (*Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet*):

Aktiviteti 1:

Projekti/Produkti rezultatet e pritura dhe treguesit lidhur me: [Shpjegoni...]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni...]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni...]

\*Plotëso: Tabelën për aktivitet/nën-aktivitetet e projektit

Aktiviteti (Përshkrimi)	Qyteti	Vendi/ data/ora	Periudha	Fusha/ Gjinia	Nr. i Audience (parashikim)	Nr. personave të angazhuar (pagesa honorar)	Partneri Zbatues

--	--	--	--	--	--	--	--

### Shënim:

- Ju lutem, shënoni **Aktivitetin** me të gjitha të dhënat që kërkohen.

**Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara?** (*Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përbledhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.) Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]*

**Qëndrueshmëria e projektit** – impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si dhe individit ose organizatës që e propozon.

*Maksimumi 5 rreshta: [ Shpjegoni...]*

**Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit, a është respektuar e drejta e autorit?**

*Maksimumi 5 rreshta: [ Shpjegoni...]*

### PJESA III: PARTNERËT (NËSE KA)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve. (*Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve duke përshkuar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.) Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]*

#### Partneri 1 (Aplikanti)

Misioni. Cili është misioni i organizatës suaj?

*Maksimumi 5 rreshta: [ Shpjegoni...]*

**Struktura.** Përshkruani strukturën e organizatës duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

*Maksimumi 5 rreshta: [ Shpjegoni...]*

**Financimi.** Si financohet organizata juaj dhe cili ishte buxheti I saj për vitin paraardhës?

*Maksimumi 5 rreshta: [ Shpjegoni...]*

#### Partneri 2

Emri organizatës: [ Shpjegoni...]

Personi i kontaktit: \_\_\_\_\_

E-mail: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Faqja në internet: \_\_\_\_\_

Etj.

#### **PJESA IV: BUXHETI**

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruara dhe të mundshme?

**\*PLOTËSO TABELËN PËR KOSTOT FINANCIARE TË PROJEKTIT- sipas Aneksit 2**

## Aneksi 2

## Projekti :

### Aplikanti:

Koha e zbatimit: nga/deri:

<b>4.</b>	<b>SHPENZIME TEKNIKE</b> <i>(Ndriçim, Foni, etj.)</i>								
4.1									
4.2									
4.3									
4.4									
	<b>TOTAL 4</b>								
<b>5.</b>	<b>SHPENZIME TË TJERA</b>								
5.1									
5.2									
5.3									
5.4									
	<b>TOTALI 5</b>								
<b>TOTAL (edhe në %):</b>									

**Ju lutem shtoni linja buxhetore për çdo aktivitet.**

**Sqarim:**

1. Ju lutemi të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe vetë aplikantin), edhe si % e buxhetit total për projektin;
2. Vlerat financiare të paraqitura në këtë formular, duhet të jenë të shprehura në LEKË.